 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 1 nga 6

Kontratë me organet e vlerësimit të konformitetit (Marrëveshje e akreditimit)

I. SUBJEKTET

Sot më datë _____, është lidhur kjo kontratë, midis palëve të mëposhtme (këtu e në vijim referuar si “Kontrata”):

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me numër unik identifikimi (NIPT)....., me seli në adresën “Rruga e Durrësit”, Nr.27,Kati:III-të.Tel:+355 4 2269097; e-mail: info@dpa.gov.al, Tiranë, e përfaqësuar në këtë Kontratë nga Drejtor i Përgjithshëm Znj. Pranvera Fagu (këtu e në vijim referuar si “DPA”)

dhe

Organit të Vlerësimit të Konformitetit

themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, regjistruar me numër unik identifikimi (NIPT) _____, me zyrë qendrore në adresën: Rr. “.....” _____, _____, përfaqësuar nga Znj/Z. _____, në cilësinë e _____, (këtu e me poshtë referuar si “OVK/Aplikanti”)


i cili ka aplikuar për: (Këtu plotësohet aktiviteti i vlerësimit të konformitetit dhe standardi i akreditimit për të cilin OVK po aplikon (psh. testim- ISO/IEC 17025) _____

DPA dhe OVK referohen këtu e në vijim bashkërisht si “Palët”, ose veçmas si “Pala

Baza Ligjore: Ligji Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 667, datë 29.7.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit”, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 737, datë 9.9.2015 “Për përcaktimin e tarifave të Akreditimit dhe për trajnimet e organizuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit” i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon përkatësisht marrëdhëniet në Republikën e Shqipërisë.

Palët bien dakort si më poshtë:

II. OBJEKTI I KONTRATËS


 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 2 nga 6

Kjo kontratë rregullon marrëdhëniet juridike / financiare dhe bashkëpunimin ndërmjet DPA-së dhe OVK-së në lidhje me aktivitetet e vlerësimit, akreditimit, mbikëqyrjes dhe rivlerësimit të zbatuara nga DPA-ja në aktivitetet e saj për qëllime akreditimi.

III. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

1. Detyrimet e OVK-s:

- 1.1. Të njohë dhe zbatojë politikat dhe procedurat e akreditimit të DPA -së.
- 1.2. Të ndjekë në mënyrë të vazhdueshme rekomandimet dhe/ose shtesat/ndryshimet e procedurave të akreditimit të kryera nga DPA.
- 1.3. Të angazhohet që të përmbushë vazhdimisht kërkesat për akreditim për qëllimin për të cilin kërkohet apo jepet akreditimi dhe të angazhohet për të siguruar dëshmi të përmbushjes.
- 1.4. Të përshtatet me ndryshimet në kërkesat për akreditim.
- 1.5. Të bashkëpunojë sa të jetë e nevojshme për të mundësuar që DPA të verifikojë përmbushjen e kërkesave për akreditim.
- 1.6. Të sigurojë akses në personelin, vendndodhjet, pajisjet, informacionin, dokumentet dhe regjistrimet e OVK-së, sipas nevojës, për të verifikuar plotësimin e kërkesave për akreditim në vlerësimin fillestar, vizitat e mbikëqyrëse, në rivlerësim, vizitat shtesë dhe ato të paplanifikuara.
- 1.7. Të sigurojë sipas kërkesës së DPA-së zhvillimin e vlerësimit me dëshmi.
- 1.8. Të sigurojë kushte të përshtatshme pune për grupin vlerësues të caktuar nga DPA për realizimin e planeve të vlerësimit/mbikëqyrjes/rivlerësimit
- 1.9. Të pranojë vizitë periodike të mbikëqyrjes të organizuar nga DPA të paktën një herë në vit.
- 1.10. Ti japë DPA informacion rreth aktiviteteve të saj, për qëllime të vizitave mbikëqyrëse brenda një kohe të përcaktuar.
- 1.11. Të pranojë vizita shtesë (të jashtëzakonshme) të organizuara nga DPA, në rast të ankesave ose ndryshimeve që ndikojnë në akreditim.
- 1.12. Të pranojë vizitat e paplanifikuara të organizuara nga DPA, aty ku është e nevojshme.
- 1.13. Të marrë pjesë në testet e zotësisë dhe/ose krahasimet ndërlaboratorike, në rastin kur OVK është laborator testimi / kalibrimi / mjekësor, ose kur është e përshtatshme, një organ inspektimi ose organ certifikimi produkti.
- 1.14. Të ketë, aty ku është e mundur, një marrëveshje të detyrueshme ligjore me klientët e saj, që i angazhon klientët të ofrojnë, sipas kërkesës, akses për grupin e vlerësimit të DPA-së për të vlerësuar performancën e OVK-së gjatë kryerjes së aktiviteteve të vlerësimit të konformitetit në vendndodhjen e klientit.
- 1.15. T'i referohet akreditimit vetëm në lidhje me fushën për të cilin i është dhënë akreditimi.
- 1.16. Të zbatojë politikën e DPA-së për përdorimin e simbolit të akreditimit.
- 1.17. Të mos e përdorë akreditimin e saj në mënyrë të tillë që të cojë në diskreditimin e DPA-në.
- 1.18. Të mos përdorë simbolin e akreditimit për çdo aktivitet, duke përfshirë edhe aktivitetet që përfshijnë reklamimin, nëse periudha e vlefshmërisë së certifikatës së akreditimit ka skaduar ose nëse akreditimi është pezulluar ose tërhequr.
- 1.19. Të informojë DPA-në, brenda një muaji, për ndryshimet që lidhen me akreditimin e saj, siç janë: statusi ligjor, tregtar, pronësia ose statusi organizativ; organizata, menaxhmenti i lartë

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 3 nga 6


dhe personeli kyç, burimet dhe lokacioni, fushëveprimi i akreditimit; ose çështje të tjera që mund të ndikojnë në aftësinë e OVK për të përmbushur kërkesat për akreditim.

- 1.20. Të paguajë tarifën për vlerësimin, akreditimin, vizitat mbikëqyrëse, vizitat e jashtëzakonshme, vizitat e paplanifikuara dhe rivlerësimin në kohë sipas tarifave të përcaktuara në VKM nr. 737, datë 09.09.2015 "Për Përcaktimin e Tarifave të Akreditimit dhe për Trajnimet e Organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ", i ndryshuar.
- 1.21. Të asistojë dhe ndihmojë në hetimin dhe zgjidhjen e çdo ankese lidhur me akreditimin në lidhje me OVK-në të adresuar nga DPA.
- 1.22. Me kërkesë të DPA-së, të sigurojë informacion mbi ankesat e marra nga OVK lidhur me fushën e akreditimit, duke përfshirë zgjidhjen e tyre që mund të përfshijë korrigjime ose veprime korrigjuese.
- 1.23. Të mos japë informacion mbi procesin e akreditimit përpara se të merret vendimi i akreditimit.
- 1.24. Të kthejë certifikatën e akreditimit në DPA në rast të tërheqjes së akreditimit.
- 1.25. Të informojë klientët e saj të prekur për pezullimin, reduktimin ose tërheqjen e akreditimit të tij dhe pasojat që lidhen me to, brenda 2 javëve.
- 1.26. Të mos përdorë akreditimin e dhënë në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e DPA-së për standardet për të cilat është akredituar OVK, siç janë:
 - a) Të mos lëshojë raporte të testimit/inspektimit/certifikimit ose certifikatave të kalibrimit të papërshtatshme ose që përmbajnë rezultate të pasakta.
 - b) Të mos japë informacione të pasakta ose të gabuara në lidhje me statusin e akreditimit përmes mjeteve të komunikimit (dokumente, reklama / publicitet, etj.).
 - c) Të mos përdorë simbolin e akreditimit, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në politikën e DPA-së për përdorimin e simbolit të akreditimit.

2. Të drejtat e OVK-së:

- 2.1. I kërkon DPA-së të gjithë informacionin e nevojshëm për akreditim, kushtet dhe procedurat përkatëse
- 2.2. Ankohet me shkrim nëse nuk pajtohet me konkluzionet e shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara së bashku me formularin e aplikimit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në procedurën e akreditimit.
- 2.3. Kundërshton përbërjen e grupit të vlerësimit sipas kushteve të përcaktuara në procedurën e akreditimit.
- 2.4. Duhet të njoftohet për rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet e grupit vlerësues. Në rastet kur ka komente mbi raportin e grupit të vlerësimit, OVK mund t'i dërgojë ato me shkrim në DPA brenda 15 ditëve pune nga dita e pranimit të raportit të vlerësimit.
- 2.5. Apelon, me shkrim, kundër vendimeve mbi akreditimin sipas procedurave të përcaktuara nga DPA.
- 2.6. Informohet nga DPA për ndryshimet në procedurat, dokumentet dhe standardet jo më vonë se një muaj nga hyrja në fuqi e tyre.
- 2.7. Informohet nga DPA për trajnimet e DPA-së të ofruara për OVK, nëse ka.

3. Detyrimet e DPA-së:


 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 4 nga 6

- 3.1. Zbaton politikat dhe procedurat e akreditimit që lidhen me OVK.
- 3.2. Siguron rishikimin e dokumentacionit dhe formularit të aplikimit në përputhje me kushtet e përcaktuara në procedurën e akreditimit.
- 3.3. Informon OVK për çdo vendim lidhur me statusin e akreditimit të tij sipas procedurave të përcaktuara nga DPA.
- 3.4. I propozon OVK-së përbërjen e grupit vlerësues në kohë sipas kushteve të përcaktuara në procedurën e akreditimit, duke ndjekur një përgjigje pozitive për shqyrtimin e dokumentacionit.
- 3.5. Siguron kryerjen e vizitës vlerësuese në ambientet e OVK sipas kushteve të përcaktuara në procedurat e akreditimit.
- 3.6. Në rastet e vendimit pozitiv për akreditim, lëshon certifikatën e akreditimit.
- 3.7. Informon OVK për rezultatet e çdo vizite mbikëqyrëse sipas kushteve të përcaktuara nga procedura e akreditimit.
- 3.8. Informon OVK për ndryshimet dhe shtesat që janë bërë në procedurën e akreditimit të publikuar nga DPA.
- 3.9. Ofron informacion në faqen e internetit të DPA-së mbi OVK të akredituar, fushën e akreditimit dhe vlefshmërinë e akreditimit.
- 3.10. Mban të fshehtë të gjithë informacionet e marra nga procesi i akreditimit të OVK. Detyrimi i DPA-së për të mbajtur konfidencialitetin do të mbetet në fuqi pavarësisht nga ndërprerja e kësaj marrëveshjeje.

4. Të drejtat e DPA-së:

- 4.1. Kërkon informacion rreth ankesave të marra nga OVK për fushën e mbuluar nga akreditimi.
- 4.2. Kërkon informacion në lidhje me dokumentacionin e sistemit të menaxhimit të OVK.
- 4.3. Ka akses në personelin, vendndodhjet, pajisjet, informacionin, dokumentet dhe regjistrimet e OVK-së, sipas nevojës, për të verifikuar plotësimin e kërkesave për akreditim në vlerësimin fillestar, vizitat e mbikëqyrëse, në rivlerësim, vizitat shtesë dhe ato të paplanifikuara.
- 4.4. Organizon të paktën një herë në vit vizita mbikëqyrëse. Nëse ka dyshime se ka një devijim nga kushtet e akreditimit ose një ankesë është nisur në DPA kundër OVK, ka të drejtë të organizojë vizita shtesë. DPA ka të drejtë të organizojë vizita të panjoftuara.
- 4.5. Pezullon procesin e vlerësimit të OVK në rast të mos prezencës së stafit të OVK
- 4.6. Nënkontraktin vlerësimin , sipas procedurës së DPA për nënkontraktim.
- 4.7. Përdor vlerësuesit ose ekspertët e huaj, duke marrë mendimin e OVK-së paraprakisht, në qoftë se rezultoni se vlerësuesit vendas ose ekspertët nuk janë në dispozicion ose kur çenohet paanëshmëria.
- 4.8. DPA ka të drejtë që, në emër të saj, të përdorë për vlerësime të aktiviteteve të vlerësimeve të konformitetit, organizma kombëtare të akreditimit të shtetit në të cilin OVK kryen vlerësime konformiteti pa qene nevoja për të njoftuar paraprakisht apo për të marrë njoftim nga OVK për këtë gjë, dhe vetëm nëse organizmi kombëtar i akreditimit i shtetit tjetër është anëtar firmosës i EA MLA për këtë skemë akreditimi dhe ofron akreditim për aktivitetet përkatëse të vlerësimit të konformitetit.
- 4.9. DPA ka të drejtë të reduktojë, pezullojë dhe tërheqë akreditimin në rast të përmbushjes së kushteve përkatëse sipas procedurës DA-PT-006.

IV. KUSHTE TË TJERA PER DHËNIEN E AKREDITIMIT

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 5 nga 6

- Pagesa për detyrimet që janë ndaj DPA duhet të bëhet sipas të dhënave në faturat për arkëtim, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, të lëshuara nga DPA, në numrin e llogarisë i cili do t'i komunikohet OVK me shkresë të veçantë nga DPA.
- Nëse grupi vlerësues i DPA-së duhet të bëjë një vizitë të dytë në vend, OVK do të paguajë shërbimin për të gjitha shpenzimet e bëra sipas pikës 1.20 të kreut III.
- Periudha e vlefshmërisë së kësaj kontrate (marrëveshje) përcaktohet nga vlefshmëria e akreditimit të dhënë ose përcaktuar nga procedurat për dhënien e akreditimit sipas kushteve dhe rregullave të përshkruara për akreditim.
- Në ciklin e parë të akreditimit, DPA planifikon dhe kryen rivlerësimin të paktën 8 muaj para përfundimit të ciklit të akreditimit. Për ciklet e tjera të akreditimit, rivlerësimi duhet të kryhet të paktën 6 muaj përpara përfundimit të ciklit të akreditimit.
Kontrata për riakreditim nënshkruhet në momentin e aplikimit për riakreditim dhe hyn në fuqi në momentin e përfundimit të afatit të kontratës paraardhëse.

V. PENALIZIMET DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- Kjo kontratë rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
- Nëse OVK nuk përmbush detyrimet sipas pikave 1.6-1.12, pikave 1.14 ose 1.20 të Kreut III të kësaj kontrate, DPA mund të pezullojë akreditimin.
- Në rast të reduktimit të fushës së akreditimit, kur OVK nuk e kthen certifikatën origjinale të akreditimit sipas rregullave të akreditimit, DPA mund të pezullojë akreditimin.
- Nëse OVK nuk përmbush detyrimet sipas pikave 1.1, 1.3, 1.4 dhe / ose 1.25 të Kreut III të kësaj kontrate, DPA mund të tërheqë akreditimin.
- Pas shterimit të të gjitha përpjekjeve për zgjidhjen paqësore të ndonjë mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose kërkesë që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë kontratë ose shkelje të kontratës, palët kanë të drejtë të aplikojnë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të kërkuar zgjidhjen me ndërgjyqësi .

VI. KONKLUZIONE

- Procedurat e akreditimit të publikuara nga DPA, si dhe ndryshimet dhe / ose shtesat, janë pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje pas publikimit të tyre në faqen e internetit të DPA.
- Të gjitha të dhënat dhe informatat ndërmjet palëve do të bëhen me shkrim.

Adresat e palëve janë si më poshtë:


DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AKREDITIMIT:

Rruga “Duresit”, Nr. 27, Tiranë

ORGANI I VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT: “Këtu plotësohet Emri i OVK ” ,

Adresa: "ketu plotësohet adresa ku ushtron aktivitetin subjekti"

Numër kontakti: "ketu plotësohet numri i kontaktit të aplikantit"

 <p>Tel: +355 4 22 69097 +355 4 22 69325 Fax: E-Mail: info@dpa.gov.al</p>	Kontrata me OVK	Kodi DA-FO-038
		Rishikim nr 6 Dt:15.01.2024
		Faqe 6 nga 6

Kontrata do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët ose përjashtimisht në rastin sipas pikës 4, në Kreun IV të kësaj kontrate dhe mund të ndryshohet vetëm nëse të dy palët bien dakord nëpërmjet marrëveshjes shtesë të shkruar – aneks.

Kjo Kontratë u hartua në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje 2 (dy) kopje për secilën Palë. Çdo kopje ka të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtën vlerë ligjore.

Për palët:

Në interes të DPA:

Znj. Pranvera FAGU

Në interes të OVK/APLIKANTI:

Z/Znj.